



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISË SE QYTETIT KORÇE**

VENDIM

Nr. 13, Datë 18 / 103 / 2008

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIE ME QIRA
TË SIPËRFAQES PREJ 250 m² TË NDODHUR NË AMBIENTET E REPARTIT
INSTRUMENTAL MEKANIK NË U.M.B. KORÇË.**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike, Sektori i Administrimit të Pronave Publike dhe Tokës, bazuar në Ligjin 8652 datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" Neni 32 pika e, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 162, datë 07.03.2007, "Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore" si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr. 562, datë 15.08.2007 "Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 162, datë 07.03.2007, "Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore" " si dhe mbas diskutimeve të Këshilltarëve:

VENDOSI:

1. Të fillojnë procedurat për dhënien me qira me anë të konkurrimit të ambientit me sipërfaqe 250 m² të ndodhur në ambientet e Repartit Instrumental Mekanik në U.M.B. Korçë, për veprimtari ekonomike prodhuese.
2. Afati për dhënien me qira do të jetë 5 vjet.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I
RAIMONDA NASE**

Raimonda Nase